



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 113/1 Prot

Tiranë 27 /07/2023

URDHËR

Nr. 113/1, Datë 27 / 07 2023

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR APLIKIME PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SHOQËRISË CIVILE QË DO TË KRYEJË VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURËS PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE, NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR dhe NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Mbështetur në nenin 2 të ligjit nr. 8454/1999 "Për Avokatin e Popullit", nenet 54-58, dhe 152-156 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë", si dhe nenin 28 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në vijim të thirrjeve nr. 07 dhe nr. 08 datë 26.07.2023 të Avokatit të Popullit për aplikime për anëtar të komisionit të shoqërisë civile që do të kryejë verifikimin paraprak të kandidatave nga shoqëria civile për anëtarët që do të përfaqësojnë shoqërinë civile në Këshillin e Lartë Gjyqësor si dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si dhe në vijim të Urdhrit nr. 113 datë 24.07.2023 të Avokatit të Popullit, në mungesë të rregullores e cila do të hartohet sipas pikës 3 gërma "b" të urdhit të sipërcituar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së dokumentacionit të nevojshëm për aplikime për anëtar të komisionit të shoqërisë civile që do të kryejë verifikimin paraprak të kandidatave për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile, në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
 - a. Vendim gjyqësor për regjistrimin e organizatës së shoqërisë civile ose vërtetim nga organet gjyqësore për regjistrimin e saj dhe objektin e veprimtarisë;
(dokumenti duhet të jetë origjinal ose i njehësuar me origjinalin)
 - b. Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
(dokumenti elektronik ose kopje e tij)

- c. Çdo dokument, material apo e dhënë që vërteton zbatimin e projekteve në fushën e sistemit të drejtësisë ose të të drejtave të njeriut në 5 vitet e fundit;
(dokumenti, materiali apo e dhëna mund të paraqitet në çfarëdolloj forme)
 - d. Dokument identifikimi të përfaqësuesit ligjor të organizatës;
2. Ngarkohet Sektori i IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve për publikimin e këtij Urdhri në faqen zyrtare web të institucionit.
 3. Ngarkohet grupi i punës krijuar me Urdhër nr. 113 datë 24.07.2023 të Avokatit të Popullit për njoftimin e këtij Urdhri sipas procedurave të parashikuara në Urdhrin e sipërcituar dhe në përputhje me ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANGA

